



**Datë:** 23.07.2025

**Numër Protokolli:** 5007/2025

**A.nr.1089/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare Ardita Haxhnikaj -Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1089/2025, të datës 09.06.2025, të parashtruar nga ankuesi F.S, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.07.2025, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Përfundon** procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.1089/2025, e datës 09.06.2025, e parashtruar nga ankuesi F.S.

## **A r s y e t i m**

Ankuesi F.S, (në tekstin e mëtejshëm referuar: ankuese), përmes emailit me datë 05.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me datë 09.06.2025 lidhur me procedurën e pranimit sipas konkursit me numër të referencës RN00016977, për Grup i Arkiv- dokumentacionit për pozitën Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve Zyra Lokale e Pensioneve në Mitrovicë, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa, kjo e fundit më datë 02.07.2025, ka përcjell përgjigje në ankesë së bashku me provat materiale referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, sepse:

Nga provat e administruara, rezulton se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 07.03.2025 ka shpallur konkursin publik me numër reference RN00016977 për Grupin të Arkiv-Dokumentacionit, respektivisht për pozitën Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve në Zyrën Lokale të Pensioneve në Mitrovicë, me klase të pozitës Profesional 2, për një (1) vend pune, i hapur për aplikim nga data 08.03.2025 deri më 06.04.2025. Nga shkresat e lëndës, po ashtu rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (47) kandidatë, ndërsa, prej tyre, kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në liste të ngushtë vetëm (10) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, me datë 02.05.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fituese, nga i cili njoftim rezulton se kandidati R.P. është vlerësuar me gjithsejtë 92.4 pikë, ndërsa ankuesi F.S është vlerësuar me gjithsejtë 72.2, dhe është renditur i treti sipas numrit rendor.

Ankuesi, ankesën e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk i është bërë vlerësim real nga ana e Komisionit të Pranimit, gjegjësisht ankuesi pretendon që procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil si dhe dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati A.K, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016977, për pozitën e punës *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve*, në Zyrën Lokale të Pensioneve në Mitrovicë, kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë të rekrutimit, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.709/2025, të datës 20.06.2025, ka anuluar në tërësi këtë procedurë rekrutimi.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1089/2025, të datës 09.06.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.709/2025, të datës 20.06.2025, rrjedhimisht ka anuluar procedurën e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00016977, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr. 1089/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundojë procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1089/2025, të datës 09.06.2025.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda: A.nr.1089/2025**

**Rushit Kajtazi**

Procesmbajtës

**Malsore GASHI- BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- *Ankuesit F.S;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe;*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*